

VENDIM
Nr.419, datë 9.6.2005

**PËR DISA NDRYSHIME NË DOKUMENTIN “RREGULLORJA E SHËRBIMIT TË
JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.839,
DATË 17.12.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 92 të dokumentit “Rregullorja e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.839, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

- a) Shkronja “b” e pikës 5, ndryshohet si më poshtë vijon:
“b) që ka jo më pak se 7,5 vjet punë, drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm.”.
 - b) Shkronja “b” e pikës 6, ndryshohet si më poshtë vijon:
“b) që ka jo më pak se 10 vjet punë, drejtpërdrejt, në shërbimin e jashtëm.”.
 - c) Nën-pika 7.1 e pikës 7, ndryshohet si më poshtë vijon:
“7.1 që ka jo më pak se 21 vjet vjetërsi të integruar në punë, nga të cilat jo më pak se 13 vjet, drejtpërdrejt në shërbimin e jashtëm.”.
2. Ngarkohet Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano